



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
INDUSTRIALE "PAVARËSIA" VLORË

Nr. 190 Prot

Vlorë , më 28 .03.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë ,27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE "PAVARESIA "VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për 1 pozicione pune :

- Pozicioni 1.

DEGA-TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI PËR PERSONELIN MESIMËDHËNËS TE FORMIMIT TEORIK- PRAKTIKË PROFESIONALE (me kohë të plotë)

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë si vijon:

- a)të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b)të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c)të mos jetë I dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d)të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e)të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjeljes dhe komunikimit
- f)të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës teorik-praktikës profesionale në ofruesit e AFP-së si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme ,në të njejtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- b) të ketë të paktën 3(tre)vite përvojë pune në fushën ,ne te cilen ka kryer studimet .
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për vendin e lirë , duhet të përfshijë: -

- a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) - librezën e punës;
 - f) - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
 - i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - j) - vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
3. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës , 7. 04. 2023

DREJTOR
ING.GENTIAN BOCI

